



Technical Secretariat of the
National Water Council

PREZANTIM I HAPAVE TË NDËRMARRA PËR HARTIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT SEMAN, FAZA KU NDODHET

VLORË, 28 QERSHOR 2018

SITUATA


➤ Statusi i projektit

- Hartimi i PMBU Seman është ende në proces;
- Është një komponent i PROJEKTIT TË BURIMEVE UJORE DHE UJITJES;
- Projekti është financuar nga Banka Botërore, Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) dhe Qeveria Shqiptare;
- Kontratë midis Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe MOTT MACDONALD LTD(UK), në bashkëpunim me DHI GROUP(Danimarkë) dhe ABKONS(Shqipëri),e nënshkruar në qershor 2015.

Q Ë L L I M I

- Njohja me procesin e hartimit të “Planit të menaxhimit të basenit të lumit Seman”
- Nxjerrja në pah e përparësive dhe mangësive të këtij draft plani;
- Të dilet në një përfundim, për hapat në të ardhmen.

KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE



- Lumenjtë : Lumi Seman (Osumi, Devolli, Lumi i Gjanicës) (H=863 m mnd)
- Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 5649 km²
- Laguna e Karavastasë

Q Ë L L I M I I P M B U S E M A N

- Identifikimi i një sërë masash prioritare me kosto efektive për të përmirësuar efikasitetin e menaxhimit dhe përdorimit të burimeve ujore në basen, duke përfshirë detyra kryesore si:
 - analiza e gjendjes fizike të burimeve ujore në basen;
 - shqyrtimi i të gjitha llojeve të përdorimit ekonomik të ujit në basen dhe ndikimet e tyre në situatën e burimeve ujore;
 - inventarizimi i burimeve ujore në basen;
 - vlerësimi i balancave të burimeve ujore ekzistuese dhe të ardhshme në basen;
 - identifikimi i sfidave kryesore të menaxhimit të burimeve ujore në basen, duke përfshirë sasinë dhe cilësinë;
 - vlerësimi i rolit kufizues të ujit për përmbushjen e objektivave të zhvillimit ekonomik në basen;
 - identifikimi i një sërë veprimesh dhe investimesh të nevojshme për të përmirësuar situatën e burimeve ujore në basen.
- Përafrim dhe rakordim me kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit;
- Rekomandime dhe orientime për Autoritetet përkatëse vendore, se si duhet të marrin pjesë dhe hartojnë planet e menaxhimit në të ardhmen.

PËRMBAJTJA E DRAFT PLANIT

- Karakteristikat e përgjithshme të basenit ujor;
- Presione të rëndësishme në basenin ujor (që përfshijnë ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, si dhe presione dhe ndikime të tjera);
- Analiza ekonomike e përdorimit të ujit;
- Zonat e Mbrojtura;
- Monitorimi i rrjeteve për ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe ujërat bregdetare;
- Statusi i ujit dhe Infrastruktura ujore;
- Menaxhimi i përmbytjeve;
- Objektivat mjedisore;
- Programi masave.

MANGËSITË

- Mungon raporti i VSM-së;
- Të dhënat mbi popullsinë nuk janë të përditësuara;
- Ka mungesë të të dhënave historike në lidhje me cilësinë e ujit;
- Nuk është bërë përshkrimi i të gjitha rezervave sipërfaqësore ujore dhe rezervave të ujërave nëntokësore;
- Mungon plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet;
- Afati kohor i përfundimit të kontratës është kaluar;

PROBLEMATIKAT

- Problematikat që parashtron ky draft plan kanë të bëjnë me:
- Informacionet;
- Presionet e identifikuara janë kryesisht :
 - ✓ Shkarkimet e ujërave të zeza në shtratin e lumit;
 - ✓ Vendgrumbullime të improvizuara të depozitimeve të mbetjeve të ngurta, pranë shtratit të lumit;
 - ✓ Ndotjet difuzive nga industrinë;
 - ✓ Ndotje difuzive nga bujqësia;
 - ✓ Nxjerrja pa kriter e zhavorrit;
 - ✓ Hidrocentralet;
 - ✓ Ndotja e ujërave nëntokësore ;
 - ✓ Turizmi.
- Mungesa e rrjetit të Ujësjellës-Kanalizime;
- Nuk ekziston një përcaktim i zonave të mbrojtjes përreth puseve individuale;
- Nuk ekziston një përcaktim i zonave të ndjeshme nga shkarkimet e ujërave të ndotura dhe nga lëndët ushqyese;
- Mungesa e stacioneve të monitorimit;
- Mosfunksionimi i stacioneve të pompimit dhe kullimit;
- Nevojitet përgatitje teknike e stafeve për të bërë identifikimin dhe klasifikimin e risqeve.

OBJEKTIVAT

Objektivat e draft PMBU Seman, janë mbështetur në objektivat e SKMIBU dhe PKS. Ato fokusohen në:

- Sasia e ujit;
- Cilësia e ujit;
- Rreziqet e ujit;
- Informacioni mbi ujën
- Menaxhimi i ujit.

PROPOZIMET

Ky version i planit propozon këto masa dhe veprime në menaxhimin e basenit lumor në të ardhmen :

- Transpozimi i Direktivës së Ujërave Nëntokësore (2006/118/KE);
- Caktimi i përgjegjësive dhe detyrave të qarta ndërmjet AMBU-së, ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe SHGJSH-së për monitorimin e trupave ujorë nëntokësore;
- Koordinimi gjithashtu me institucionet e monitorimit të ujit të pijshëm dhe kompanitë e furnizimit me ujë që janë nën pushtetin vendor.
- Identifikimi fillestar i Trupave ujorë nëntokësorë në përputhje me DKU-në përpara zhvillimit të programit të monitorimit të ujërave nëntokësore dhe identifikimin e trupave ujore nëntokësore, për të cilat ekzistojnë ekosisteme ujore sipërfaqësore ose ekosisteme tokësor të varura drejtpërdrejt;
- Zhvillimi i një programi monitorimi me objektiva të qarta, llojin e monitorimit, vendet e monitorimit, frekuencat dhe parametrat që janë përfaqësues dhe tregues të kushteve vendore;
- Përfshirja e zonave të prioritetit të parë monitorues sa më shpejt të jetë e mundur;
- Koordinimi me ARZM të rajoneve përkatëse në BU Seman;

PROPOZIMET

- Përfshirja e monitorimit biologjik në planin e monitorimit të basenit ujor sa më parë të jetë e mundur;
- Për masat institucionale, të përmirësohet struktura organizative për menaxhimin e basenit lumor;
- Për kuadrin ligjor, organizimi i kontrollit të cilësisë në hartimin e legjislacionit dhe zvogëlimi i numrit të akteve nënligjore;
- Për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet propozohet si fillim të kryhet vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet;
- Për ndërtimin e kapaciteteve propozohen investimet në njerëz;
- Për infrastrukturën e vjetëruar, të krijohet portofoli dhe pajisjet e zëvendësimit;
- Përshkrim më i hollësishëm i ndikimeve të pikave të nxehta dhe burimet shpërndarëse të ndotjes mjedisore;
- Zhvillimi i objektivave të cilësisë mjedisore dhe sasiorë për ujërat sipërfaqësore dhe rezervave ujore nëntokësore;

REKOMANDIME

- Të përcaktohet sasia e ujit ekologjik që duhet të respektohet nga përdoruesit, për zona specifike;
- Matja e parametrave mikrobiologjikë;
- Matja e parametrave biologjikë dhe fiziko – kimikë;
- Të bëhet një analizë më e plotë socio-ekonomike ku të identifikohen presionet që kanë burimet ujore nga urbanizimi i zonave të ndryshme;
- Koordinimi institucional për ushtrimin e një kontrolli të specializuar dhe penalizimin e subjekteve që nuk zbatojnë kriteret, sidomos për sa i takon ruajtjes së ambjentit dhe ekosistemit natyror.

K O N K L U Z I O N E

- Draft plani ekzistues i menaxhimit mund të shërbëjë si guidë për specifikimin e TR për hartimin e rishikimit të radhës, në mënyrë që në fazën e rishikimit të hartohet një plan më konkret menaxhimi.
- Të bëhet një vlerësim teknik dhe ekonomik dhe të sigurohen fonde për përmbushjen e masave dhe veprimeve të propozuara në plan.
- KBU dhe ZABU Seman duhet të marrin pjesë aktive në gjithë procesin e hartimit të planit të menaxhimit të burimeve ujore për këtë basenin, duke përmbushur detyrimet e tyre ligjore në këtë proces. *(Duke iu referuar Vendimit të KKU-së Nr.1 datë 17.2.2015, rishikimi i planit të menaxhimit fillon 3 vite përpara përfundimit të planit që është në fuqi).*



Technical Secretariat of the
National Water Council

FALEMINDERIT !